



Universiteti i Prishtinës
UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

Fakulteti i Mjekësisë

Bulevardi i Dëshmorëve p.n, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381-38-512221 URL: <http://www.uni-pr.edu>
Fax: +381-38-512223 Mail: mjekesia@uni-pr.edu

UNIVERSITETI I PRISHTINES
FAKULTETI I MJEKESISE
PRISHTINE

Pranuar me dt 01.09.2025

Emri i studentit	Matësia	Udhëzuesi	Vlera
6966			

Ref. nr. Prishtinë, /09/2025

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë kandidatët të cilët janë të interesuar për Transfer nga Universitetet e tjera publike në Fakultetin e Mjekësisë - Universitetin e Prishtinës, se afati për aplikim për transfer është prej datës 01.09.2025 deri me datën 15.09.2025.

Kandidatët mund të paraqesin kërkesë me shkrim për lejimin e transferit duke iu referuar Statutit të Universitetit të Prishtinës.

Kërkesat për transfer, mund t'i paraqesin në Arkivë të Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë.

Ndërrimi i programit të studimeve sipas Statutit të UP-së të miratuar në 19.7.2024

Neni 110

Ndërrimi i programit të studimit

1. Ndërrimi i programit të studimit është i mundur në mes programeve të studimit me qëllim të arritjes së nivelit të njëjtë të arsimit në pajtim me dispozitat e këtij statuti.
2. Studenti mund të ndërrojë programin duke kaluar në program të ri në vitin e dytë e tutje të studimeve në rast të ndërrimit të programit si për shembull ndryshimet në emërtim të programit pas procesit të akreditimit/riakreditimit.
3. Studenti mund të ndryshojë drejtimin e studimit duke kaluar në një program të afërt brenda ose jashtë njësisë akademike dhe procesi i lejimit të lëvizjes, kriteret, dhe ekuivalentimi i arritjeve në programin e vjetër vendosen nga njësia akademike por duke mos ra ndesh me dispozitat e statutit dhe aktet tjera të universitetit.
4. Njësitë akademike nuk duhet të anashkalojnë kapacitetet në dispozicion për programin në të cilin regjistrohet studenti si dhe respektojnë kufizimet në kuotat për atë program të caktuara nga autoriteti i akreditimit. Ndërrimi i drejtimit të studimit nuk mund të bëhet nëse studenti nuk ka kryer obligimet e vitit të parë në programin e vjetër.

Neni 111

Procedura për ndërrim të programit të studimit

1. Studenti duhet t'ia dorëzojë kërkesën për ndërrimin e programit të studimit komisionit për studime të njësisë akademike, ku dëshiron të vazhdojë studimet. Bashkëngjitur me kërkesën duhet të jetë evidenca për plotësimin e suksesshëm të kërkesave bazuar në programin e mëparshëm të studimit.
2. Komisioni i studimeve përcakton detyrimet individuale për ndërrimin e programit të studimit në pajtim me rregullat e caktuara të programit të studimit.
3. Vendimi për ndërrimin e programit të studimit duhet të merret nga këshilli i njësisë akademike me propozimin e komisionit të studimeve.

Neni 112

Ndërrimi i programit nga një universitet tjetër

Gjatë ndërrimit të programit të studimit prej një universiteti tjetër në Universitetin e Prishtinës do të vlejné rregullat e njëjta si ato gjatë ndërrimit të programit të studimit brenda universitetit.

- *Të drejtën e transferim ta ketë: studentija i /e cili /a i ka të plotësuara kriteret e njëjta me studentet e Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës (UP-FM).*
- *Numri i studentëve të transferuar të jetë 5% i numrit të studenteve të rregullt të vitit të tretë, të vitit të katërt dhe të vitit të pestë.*
- *Përqindja e studenteve të llogaritet në raport me vitin paraprak.*
- *Në rastet kur më shumë kandidatë përmbushin kushtet e lartcekura të transferit, atëherë përparësi të ketë nota mesatare.*
- *Në rastet kur më shumë kandidatë përmbushin kushtet e lartcekura të transferit dhe kanë notë mesatare të njëjtë, atëherë përparësi t'i jepet studentit me numër më të madh të provimeve të kaluara.*

Kandidatët duhet të paraqesin:

- *Certifikatën e notave të nënshkruar, vulosur dhe protokoluar nga Universiteti-Fakulteti përkatës*
- *Vërtetimin e statusit si student i rregullt*
- *Planprogramin e studimeve*

Vërejtje: Asnjë dokument shtesë pas përfundimit të afatit për aplikim nuk pranohet si dokument për shqyrtim !!

Kërkesat për transfer, mund t'i paraqesin në Dekanatin e Fakultetit të Mjekësisë - Arkiv- **prej datës 01.09.2025 deri me datën 15.09.2025 (ora 15:30)**



Fakulteti i Mjekësisë

UP